



Autoriteti Shtetëror për
Informacionin Gjeohapësinor



Universiteti Politeknik
Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë,
Ujit dhe Mjedisit

Nr. 252 prot. Tiranë, më 02.08 2016

Nr. 217 prot. Tiranë, më 26.07 2016



Komanda e Forcave Detare

Nr. 3134 prot. Tiranë, më 03.08 2016

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR (ASIG)

UNIVERSITETIT POLITEKNIK
INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE, ENERGJISE, UJIT DHE MJEDISIT (IGJEUM)

KOMANDËS SË FORCËS DETARE, DURRËS (KFD)

E lidhur sot më datë 21.07 2016, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Themeluar në bazë të ligjit
Nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të

të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, me seli në Tiranë, me numër identifikimi NIPT: L31919452G me Drejtor të Përgjithshëm Z. Lorenc Çala.

Instituti të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), është institut shkencor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, i themeluar më vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 561 date 22.08.2007, me seli në Tiranë, me numër identifikimi NIPT L12128451T me Drejtor Prof. Asoc. Fatos Hoxhaj.

Komanda e Forcës Detare, të Republikës së Shqipërisë, me vendkomandë në Durrës, është strukturë në vartësi të Ministrisë Mbrojtjes, me Komandant Gjeneral Ylber Dogjani.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar sipas nenit 14 të ligjit 9521 datë 8.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, është *“institucion tekniko - shkencor shtetëror në përbërje të Forcave Detare të Republikës së Shqipërisë, që drejton, organizon dhe përpunon botimin e hartave detare, të vjetarëve, të udhëzuesve të lumdrimit e të fenerëve”*. Misioni i tij rregullohet nga urdri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 691 datë 18.08.2014 si dhe nga detyrimet e konventave ndërkombëtare detare.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), bazuar në nenin 7/b të ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, është përgjegjës për *“projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike”*. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 07.08.2013. “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë” i ndryshuar përcakton bazën unike gjeodezike të Republikës së Shqipërisë dhe rrjetin GNSS si një prej rrjeteve të kësaj baze. Për të bërë të mundur ruajtjen dhe funksionimin e pandërprerë të punës së rrjetit GNSS në nenin 8/1 të VKM-së 669 datë datë 07.08.2013 (e ndryshuar me VKM-në nr. 322 datë 27.04.2016) është sanksionuar përdorimi i territoreve të institucioneve qendrore, vendore e shkencore si dhe ruajtja fizike dhe furnizimi me energji i stacioneve të referencës me regjistrim të pandërprerë (CORS: Continuous Operating Referencë Stations). Udhëzimi nr. 3, datë 06.09.2013, “Për përcaktimin e pikave gjeodezike me ndihmën e Sistemeve Globale Satelitore të Navigimit (GNSS)”, zyrtarizon rregulla dhe standarde që lidhen me ndërtimin dhe përdorimin e sistemeve GNSS për përcaktimin e koordinatave të pikave të ndryshme, që përdoren për qëllime të ndryshme në territorin e vendit. ALBCORS-i është një sistem i tillë dhe është pjesë e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH).

ASIG-u për të përmbushur detyrimet e tij ligjore ka marrë përsipër të ndërtojë një rrjet të ri të integruar Gjeodezik (ALBCORS) duke shfrytëzuar infrastrukturën e ngritur të rrjetit ekzistues Gjeodezik të IGJEUM-it me synim modernizimin dhe unifikimin e rrjetit ALBCORS. Kjo do të konsistojë në shpërndarjen hapësirë, shtimin fizik të stacioneve të rrjetit, modernizimin me teknologji të reja, transmetimin e pandërprerë e në kohë reale (online) dhe instalimin e stacioneve në bazamente betoni të monometalizuara në shkëmbinj rrënjësorë, për të përmbushur kondicionet e një rrjeti gjeodezik GNSS të rendit të parë.

Gjithashtu ASIG-u në këtë kuadër ka shprehur interes për bashkërendimin dhe unifikimin e Rrjetit ekzistues me rrjete të tjera analoge që operojnë në vendin tonë. Unifikimi i rrjeteve ekzistuese GNSS të vendit tonë do të rrisë performancën e tyre dhe do të bëjë të mundur mbulimin sa më të mirë të gjithë territorit të vendit (me rreze 30-35km). Kjo do të përmirësojë dukshëm informacionin e grumbulluar, ruajtjen e tij dhe përdorimin e tij me lehtësi nga të tretët. Unifikimi i

rrjeteve GNSS të vendit do të sjellë dhe një ulje të kostove financiare të shërbimit për mirëmbajtjen fizike dhe funksionimin normal të tyre, si dhe për transmetimin e shërbimit të dhënave.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) që prej vitit 2002 e në vijim ka në administrim një rrjet GNSS-je të përbërë fillimisht nga 6 stacione dhe nga viti 2014 e në vijim ai është shtuar dhe me tre stacione të rinj, duke u bërë me 9 stacione aktive. Rrjeti GNSS është pjesë përbërëse e Rrjetit Sizmologjik Shqiptar dhe është ndërtuar konform kushteve teknike të një rrjeti gjeodinamik. Transmetimi i të dhënave të grumbulluara nga rrjeti GNSS i IGJEUM-it për katër stacione realizohet nëpërmjet sistemit satelitor VSAT dhe pjesa tjetër (5 stacione) me radiolink. Nga ky rrjet, nga ngritja fillestare e deri më sot, janë grumbulluar të dhëna të rëndësishme mbi dinamikën e lëvizjes së korës tokësore të vendit tonë. Të dhënat e grumbulluara nga Rrjeti Gjeodinamik Shqiptar shërbejnë për vlerësimin e rrezikut sizmik të vendit tonë. Ato publikohen rregullisht në faqen zyrtare (Web) të IGJEUM-it) dhe janë përdorur nga studiues dhe institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Aktualisht Rrjeti Gjeodinamik Shqiptar, i administruar nga IGJEUM, ka nevojë për rinovim të teknologjisë së regjistrimit (marrës të rinj GNSS) dhe për dendësim të rrjetit me stacione të reja, në përputhje me ndërtimin e mjedisit gjeologjik të vendit tonë.

Rrjeti Mareografik Shqiptar permanent ende nuk ekziston në Republikën e Shqipërisë. Shërbimi Hirografik Shqiptar për të realizuar misionin e tij në bashkëpunim me shërbime të huaja hidrografike ka kryer matje mareografike të herëpashershme. Nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin Hidrografik Norvegjez janë duke u ndërtuar dy mareografë përkatësisht në Sarandë dhe Durrës si dhe qendra e kontrollit që do të administrohet nga Shërbimi Hidrografik Shqiptar.

Bazuar në gjendjen aktuale të rrjeteve gjeodezike në Shqipëri, me qëllim unifikimin dhe certifikimin e tyre në zbatim të ligjit 72/2012 (nenet 7 dhe 22), si dhe të VKM-së nr. 669 datë 7.08.2013 (e ndryshuar me VKM-në 322 datë 12.04.2016):

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi (referuar këtu e më poshtë si “Marrëveshje”) sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekti i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi i tre institucioneve (ASIG, IGJEUM, KFD) për krijimin e bazës unike gjeodezike të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ndërtimit të rrjetit të stacioneve të përhershëm GNSS me regjistrim të pandërprerë (ALBCORS) në pronësi të ASIG-ut, stacioneve të rrjetit sizmologjik (sensorëve sismikë dhe akselerografik) të IGJEUM-it si dhe stacionet e rrjetit mareografik në varësi të KFD-së (Shërbimit Hidrografik Shqiptar), në territore të administruara nga KFD, si dhe ngritjen e një sistemi të unifikuar për mbledhjen, transmetimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për qëllime të përbashkëta.

Një pjesë e stacioneve të rrjetit ALBCORS, stacioneve të rrjetit sizmiologjik si dhe stacionet e rrjetit mareografik do të vendosen në territore në administrim të KFD-së, sipas *Aneksit 1* bashkëlidhur kësaj marrëveshje.

NENI 2

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Përgjegjësitë e ASIG-ut.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) merr përsipër sa më poshtë vijon:

1. Ndërtimin e rrjetit të stacioneve ALBCORS, pjesë e Rrjetit Gjeodezik Shqiptar, në përputhje me standardet që kërkohen për një rrjet të rendit të parë, që konsiston në: - ndërtimin e bazamenteve të reja të monumentalizuara në kondita shkëmbi ose trualli të fortë (pas përzgjedhjes së bërë nga grupi i përbërë nga ASIG, IGJEUM, KFD dhe Kontraktori); - ndërtimin e ambienteve ku do të vendosen marrësit satelitorë (GNSS) dhe aksesorët përkatës (sistemet e ushqimit, router, etj.) për funksionimin normal dhe transmetimin e të dhënave.
2. Garantimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të stacioneve ALBCORS, përfshirë ato që do të vendosen në ambientet që do ofrojë KFD.
3. Garantimin e lidhjes me Internet për të gjithë stacionet e ALBCORS, përfshirë ato që do të vendosen në ambientet që do ofrojë KFD.
4. Të garantojë ofrimin e të dhënave të qendrës së kontrollit të stacioneve ALBCORS për IGJEUM-in dhe KFD për qëllime të punës së tyre.
5. Të ndërtojë një faqe Web për publikimin e të dhënave të grumbulluara dhe të përpunuara nga qendra e kontrollit të stacioneve ALBCORS, si dhe nga çdo burim tjetër - pjesë e rrjetit gjeodezik shqiptar.
6. Të informojë dhe të ftojë IGJEUM-in dhe KFD-në për çdo aktivitet me interes ë përbashkët që lidhet me rrjetet në përbërje të Komizës Referuese Gjeodezike Shqiptare.

Përgjegjësitë e IGJEUM-it.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), merr përsipër sa më poshtë vijon :

1. Vendosijen e pajisjeve sizmike (sensorëve sizmikë dhe akselerografikë), në përputhje me standardet që kërkohen për këtë qëllim, në terroret që administrohen nga KFD.

2. Garantimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të pajisjeve, që do të vendosen në ambientet që do ofrojë KFD
3. Të vejë në dispozicion të ASIG dhe KFD-së informacionin historik dhe adekuat që disponon apo grumbullon nga stacionet sizmiologjike, për qëllime të punës së tyre
4. Të informojë dhe të ftojë ASIG-un dhe KFD-në për çdo aktivitet operacional që Departamenti i Sizmologjisë mund të kryejë në stacionet gjeodinamik që janë pronë e IGJEUM-it.

Përgjegjësitë e KFD

Komanda e Forcave Detare (KFD) merr përsipër sa më poshtë vijon :

1. Të vejë në dispozicion territoret e saj, sipas aneksit I për ngritjen e stacioneve multifunkionale (stacionet ALBCORS, stacionet sizmiologjik, stacionet mareografike) në funksion të ndërtimit të bazës unike gjeodezike të Republikës së Shqipërisë.
2. Sigurimin fizik dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike për të gjithë stacionet multifunkionale në territoret që do ofrojë KFD, në administrim të saj.
3. Të garantojë ofrimin e të dhënave të qendrës së kontrollit të stacioneve mareografike për ASIG-un dhe IGJEUM-in, për qëllime të punës së tyre.
4. Garanton bashkëpunim dhe akses të plotë të punonjësve të ASIG-ut (Kontraktorit) dhe të IGJEUM-it për ndërtimin e stacioneve multifunkionale (stacionet ALBCORS, stacionet sizmiologjik, stacionet e rrjetit mareografik) , si dhe për të vizituar ato në rast defektesh apo riparimesh. Në çdo rast punonjësit e ASIG-ut dhe të IGJEUM-it janë të detyruar të respektojnë rigorozësh rregullat e përcaktuara për hyrjen dhe daljen nga territoret ushtarake.
5. Të informojë dhe të ftojë ASIG-un dhe IGJEUM-in për çdo aktivitet me interes të përbashkët, që lidhet me rrjetin unik gjeodezik të Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA E AKTMARRVESHJES

Kjo Akt-Marrëveshje nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet që nga momenti i nënshkrimit të saj, bazuar në VKM-në nr. 322 datë 27.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 669 datë 7.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë” e ndryshuar.

NENI 4

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet tyre me mirëkuptim. Në rast të kundërt do të zbatohen përcaktimet e legjislacionit civil në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 5

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kjo marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobi të mbarëvajtjes së saj, me propozimin e secilës palë.

Kjo Marrëveshje mbahet në 6 (gjashtë) kopje të njëjta, nga të cilat dy kopje mbahen nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), dy kopje nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) dhe 2 kopje nga Komanda e Forcave Detare (KFD).

Kjo marrëveshje nënshkruhet sot me datë 21/07/2016 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

Për Autoritetin Shtetëror për
Informacionin Gjeohapësinor

Msc. Lorenc ÇALA

DREJTOR



Për Institutin e Gjeoshkencave,
Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

Prof. Asoc. Entos HOXHAI

DREJTOR



Për Komandën e Forcave Detare

Gjeneral Ylber DOGJANI

KOMANDANT



ANEKSI I.

Emërtimi i stacioneve të KFD-së si dhe koordinatat e përafërta të vendndodhjes së tyre (qytetit) që do të përdoren për ndërtimin e stacioneve multifunktionale.

Sistemi Koordinativ Referencë - KRGJSH

Nr.	Vendndodhja e stacionit të KFD-së	Emërtimi	Φ^0	Λ^0	H (m)
1	Vlorë (Orikum)	Flotilja Detare Pashalimani e FD	40° 19' 41"	19° 25' 09"	17
2	Sarandë	Vend Bazim i FD	39° 52' 35"	20° 00' 07"	10
3	Durrës	Vend Bazim, Kepi Palit (Bishti i Pallës)	41° 24' 34"	19° 23' 49"	4
4	Shëngjin	Vend Bazimi i FD	41° 48' 38"	19° 34' 51"	8